



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:077168
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05729256

PAKR.nr.197/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Vaton Durguti - kryetar i kolegjit, Afërdita Bytyçi dhe Bashkim Hyseni - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: F.M., A.M., Q.M., E.M., A.B., M.D., G.M., M.M., K.B. dhe D.M., për shkak të veprës penale në bashkëveprim, Kontrabandimi me migrantë nga neni 164, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr. 683/2020, datë 20.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr. 683/2020, datë 20.02.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr. 683/2020, datë 20.02.2024, të akuzuarit: F.M., A.M., Q.M., E.M., A.B., M.D., G.M., M.M., K. B. dhe D.M., në mbështetje të nenit 363 par. 1 nënpar. 1.1 të KPPK-së, i ka liruar nga akuza për veprën penale në bashkëkryerje, Kontrabandimi me migrantë nga neni 164, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sepse vepra për të cilën të akuzuarit janë akuzuar nuk përbën vepër penale. Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës t'a ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shpall fajtor për veprën penale për të cilën janë akuzuar ose aktgjykimin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit F.M., av. Rr.K., me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj si të drejtë dhe të ligjshëm.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A.B. avokat B.C., me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur edhe mbrojtësi i të akuzuarit M.D., avokat N.P., me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj.

Prokurori i Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.186/2024, datë 26.03.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit të shpallën fajtor për veprën penale për të cilën janë akuzuar, ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa

përgjigjet e mbrojtësve të akuzuarve F.M. av. Rr.K., A.B., avokat B.C. dhe M.D. avokat N.P. të refuzohen të pabazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, është caktuar dhe mbajtur seanca e kolegjit në të cilën prezantuan të akuzuarit F.M., A.M., Q.M., M.D., M.M., K.B., avokatët: Rr.K., A.B., B.C., N. P., B.I., A.A.- F., B.A. dhe I.B. ndërsa nuk prezantuan: Prokurori i Apelit dhe të akuzuarit E. M., A.B., G.M. dhe D.M., dhe avokatët D.S.-G., F. M.-S, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK, në mungesë të tyre.

Mbrojtësi i të akuzuarit, F.M., av. Rr.K., deklarojë se mbetet pranë përgjigjes së ushtruar me shkrim në ankesën e prokurorisë dhe kërkoj nga Gjykata Apelit që ankesën t'a refuzon të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj. I akuzuari F.M., deklarojë se e përkrah mbrojtësin e tij dhe nuk ka çka të shtoj më shumë. I akuzuari A.M. propozojë që të refuzohet ankesa e prokurorisë. Mbrojtësja e të akuzuarit Q.M. av. A.B. deklarojë se mbetet pranë përgjigjes në ankesën e prokurorisë dhe kërkoj që të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar. I akuzuari Q.M. deklarojë se e mbështet mbrojtësen e tij. Mbrojtësi i të akuzuarit A.B. av. B.C., deklarojë se mbetet pranë përgjigjes së ushtruar me shkrim në ankesën e prokurorisë dhe kërkoj nga Gjykata Apelit që ankesën t'a refuzon të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj. Mbrojtësi i të akuzuarit M.D., av. N.P., deklarojë se mbetet pranë përgjigjes se bërë me shkrim në ankesë të prokurorit me propozim që të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar, ndërsa ankesa e prokurorit të refuzohet si e pa bazuar. I akuzuari M.D. deklarojë se pajtohet me mbrojtësin e tij. Mbrojtësja e të akuzuarit, G.M. av. B.I. deklarojë se kërkon nga Gjykata Apelit që ankesa e prokurorisë të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. Mbrojtësja e të akuzuarit M.M. av. A.A.-F. deklaroj se i propozon Gjykatës së Apelit që ankesën e prokurorisë t'a refuzoj të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj. I akuzuari M.M. deklarojë se përkrah mbrojtësen e tij. Mbrojtësi i të akuzuarit, K.B., av. B.A., i propozoj Gjykatës së Apelit që ankesën e prokurorisë t'a refuzoj të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj. I akuzuari K.B. deklarojë se e mbështet avokatin e tij. Mbrojtësi i të akuzuarit D.M. av. I.B. deklarojë se i propozon Gjykatës se Apelit që të vërtetoj aktgjykimin e ankimuar ndërsa ankesën e prokurorisë t'a refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, përgjigjet në ankesë të

PTH-së, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë

Në ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë thekson se gjykata shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues ka bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal. Konsideron se më aktgjykimin e ankimuar me të cilin të akuzuarit F.M., A.M. Q.M. E.M., A.B., M.D., G.M., M.M., K.B. dhe D.M. janë liruar nga akuza për veprën penale në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje, Kontrabandimi me Migrantë nga neni 164 par 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe se gabimisht të akuzuarit janë liruar nga aktakuza, ngase Prokuroria i ka prezantuar prova të mjaftueshme gjykatës, të cilat prova po t'i vlerësonte drejtë Gjykata, do të vërtetohej se të akuzuarit e lartcekur kanë kryer në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje veprën penale për të cilën janë akuzuar. Aktgjykimi është jo i drejtë dhe i pabazuar dhe nuk i përmban arsyet mbi faktet vendimtare, se Gjykata nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë provat të cilat Prokuroria i ka propozuar në aktakuzë e të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prokuroria në ankesë ka cekur të gjitha provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor nga gjykata shkallës së parë, duke konsideruar se Gjykata me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar, me të cilin janë liruar nga aktakuza të akuzuarit, ka nxjerr aktgjykim jo të drejtë, të pabazuar, me të cilin aktgjykim gjykata ka bërë shkelje të ligjit penal kur të akuzuarit e lartcekur i ka liruar nga aktakuza për veprën penale të lartcekur. Andaj, nga e cekura prokuroria mbetet pranë propozimit që aktgjykimi i ankimuar të ndryshoj dhe të akuzuarit të shpallën fajtor për veprën penale për të cilën janë akuzuar, ose aktgjykimi ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilave u referohet në ankesë prokurori, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe

konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Gjithashtu kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare lidhur me veprën penale, janë të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se prokuroria nuk ka arritur të dëshmoj se të akuzuarit F.M., A.M., Q.M., E.M., A.B., M.D., G.M., M.M., K.B. dhe D.M. më qëllim të përfitimit të dobisë financiare apo të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme pas marrëveshjes paraprake, në vazhdimësi kanë bërë kontrabandimin e një numri të madh të të dëmtuarve - migrantëve personave azilkërkues që kanë qenë të strehuar në Qendrën e Azilit në fshatin Magure, Komuna e Lipjanit. Gjukata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se gjykata nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike pasi që nga provat e propozuara në aktakuzë dëshmohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit gjen se këto pretendime ankimore të Prokurorit nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikur se pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar. Nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të përshkruar si në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka administruar në shqyrtimin gjyqësor provat dhe dëshmitë si në vijim: Leximi i deklaratave të dëshmitarëve: M.A. – G. e dhënë në polici me datën 02.08.2019, I.A. – K. e dhënë në polici me datën 02.08.2019, M.M. e dhënë në polici me datën 02.08.2019, Z.A.–R. e datës 02.08.2019, M.R. të dhënë në polici me datën 30.07.2019, H.Q. të dhënë në polici me datën 30.07.2019, S.M.E. të dhëna në polici me datën 30.07.2019, dhe provave materiale si në vijim: Raporti i vëzhgimit nga Policia e Kosovës – Drejtoria për mbështetje të hetimeve – njësia e vëzhgimit – DMH i përpiluar më datë 15.07.2019, Raporti i vëzhgimit nga Policia e Kosovës – Drejtoria për Mbështetje të hetimeve – njësia e vëzhgimit – DMH i datës 09.07.2019, Raporti i vëzhgimit nga Policia e Kosovës – Drejtoria për Mbështetje të hetimeve – njësia e vëzhgimit – DMH i datës 17.06.2019, Raporti i vëzhgimit nga Policia e Kosovës – Drejtoria për Mbështetje të hetimeve – njësia e vëzhgimit – DMH i datës 18.06.2019,

Raporti i vëzhgimit nga Policia e Kosovës – Drejtoria për Mbështetje të hetimeve – njësia e vëzhgimit – DMH i datës 30.07.2019, Transkriptet e bisedave telefonike në mes të pandehurve, të shikohen 4 CD, me fotografi dhe incizime të të pandehurve, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 06.08.2019 prej të pandehurit M.D. i përpiluar nga Sektori i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare në Prishtinë me numër të rastit 2019-YI-7, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 06.08.2019 prej të pandehurit Festim Maqaj, i përpiluar nga Sektori i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare në Prishtinë me numër të rastit 2019-YI-7, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 06.08.2019 prej të pandehurit G.M. i përpiluar nga Sektori i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare në Prishtinë me numër të rastit 2019-YI-7, Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve i datës 09.10.2019 me numër të rastit 2019-YI-7 prej të pandehurit M.D. i përpiluar nga Sektori i Hetimeve – Departamenti i Policisë Kufitare Prishtinë, Procesverbali mbi kontrollin e veturës e të pandehurit M.D. e datës 09.10.2019 i përpiluar nga Sektori i Hetimeve – Departamenti i Policisë Kufitare në Prishtinë me numër të rastit 2019-YI-7, Njoftimi nga Qendra për Azil me numër 468 i datës 04.10.2019, Procesverbali numër 000199 i datës 15.11.2019 i lëshuar nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, së bashku me foto dokumentacionin e sendeve të sekuestruara, si dhe Foto dokumentacioni në shkresat e lëndës.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet ankimore të Prokurorisë se të akuzuarit me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme në vazhdimësi kanë bërë kontrabandimin e një numri të madh të të dëmtuarve migrantëve personave azilkërkues që kanë qenë të strehuar në Qendrën e Azilit në fshatin Magure, Komuna e Lipjanit, duke i'u marrë shuma të konsiderueshme të parave për ti dërguar deri tek kufiri me Serbinë, e pastaj për të depërtuar në vendet e BE-së. Kolegji pajtohet me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se të akuzuarit F.M., A.M., Q.M., E.M., A.B., M. D., G.M., M.M., K.B. dhe D.M. kanë punuar si taxist në Republikën e Kosovës, kanë bërë bartjen e azilantëve brenda territorit të Republikës së Kosovës, dhe se më asnjë nga provat e administruara nga gjykata shkallës së parë në shqyrtim gjyqësor, si ato materiale por edhe nga deklaratat e të dëmtuarve - dëshmitarëve M.A. – G., I.A. –K., M.M., Z.A.–R., M.R., H.Q., S.M.E., nuk është vërtetuar se të akuzuarit kane kryer veprën penale për te cilën janë akuzuar. Kolegji vëren se edhe nga provat materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë në asnjë prej tyre nuk mund të konstatohet fajësia e të akuzuarve në raport me veprën penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit. Dëshmitaret M.A. – G., I.A. –K., M.M., Z.A.–R., M.R.,

H.Q., S.M.E., gjatë deklarimit të tyre në polici kanë treguar se si kanë rënë në kontakt me të akuzuarit dhe kanë kërkuar prej tyre që ti bartin me veturë brenda territorit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu prokuroria nuk ka ofruar ndonjë prove materiale me të cilën do të vërtetonte se të njëjtit kanë kaluar vijën kufitare Kosovë-Serbi.

Kolegji gjen të pa bazuar pretendimin e Prokurorisë se me aktgjykimin e ankimuar është shkelur ligji penal, ngase në rastin konkret nuk janë plotësuar elementet objektive e as subjektive të veprës penale, Kontrabandimi me migrantë nga neni 164, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe si rrjedhojë nuk është vërtetuar as fajësia e të akuzuarve e cila nuk mund të supozohet por ajo për çdo rast konkret të veprës penale duhet të vërtetohet, nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Kolegji vëren se të akuzuarit kanë ushtruar veprimtarinë e tyre si taksistë, të njëjtit kanë pasur të drejtën të ushtrojnë këtë veprimtari në tërë territorin e Republikës së Kosovës, e që edhe në këtë rast, në veturat e tyre kanë hipur pasagjerët – azilantët dhe të njëjtit kanë lëvizur dhe shëtitur në territorin e Republikës së Kosovës. Azilantët kanë qenë të vendosur në kampin e azilantëve në Lipjan, të njëjtit kanë pasur të drejtën e lëvizjes në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe atë, nga ora 08:00 deri në ora 22:00. Azilantët janë zënë nga Policia e Kosovës në qytetin e Lipjanit dhe të Podujevës, nga kjo rrethanë vërtetohet fakti se azilantët kanë pasur të drejtën e lëvizjes në qytetet ku janë zënë nga Policia e Kosovës, andaj gjykata shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën të akuzuarit janë akuzuar nga Prokuroria e Shtetit.

Kolegji vëren se edhe nga provat materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë në asnjë prej tyre nuk mund të konstatohet fajësia e të akuzuarve në raport me veprën penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit.

Mbi gjendjen faktike të vërtetuar gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal, gjithashtu aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo Gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së, i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin e arsyeshëm, se nga provat e zbatuara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj, me të drejtë të akuzuarit janë liruar nga aktakuza.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.197/2024, datë 26.04.2024

Bashkëpunëtori Profesional

Kryetari i kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Vaton Durguti

Anëtarët e kolegjit:

Afërdita Bytyçi

Bashkim Hyseni